



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 16608/5 Prot.

Lezhë, më 21/10 /2025

PROCES-VERBAL

**KONSULTIM PUBLIK NË LIDHJE ME MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS
“BY-PASS-i I SHËNGJINIT”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA
LEZHË, NË FONDIN PYJOR BASHKIAK**

Data dhe vendi i mbajtjes së takimit: 21.10.2025, ora 11:00, në sallën e Bibliotekës “At Gjergj Fishta” LEZHË

Pjesëmarrësit në takim nga ana e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore:

1. Zv/Kryetari i Bashkisë Lezhë Z. Fatjon Zefi.
2. Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Ndue Luli.
3. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban Z. Flamur Kuçi.
4. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Z. Artan Palushi.
5. Sekretari i Këshillit Bashkiak Znj. Florida Çunaj.
6. Anëtare të Këshillit Bashkiak Z. Pjetër Noka, Znj. Alfrida Marku, Z. Zek Doda, Z. Pjetër Tushaj, Znj. Regjina Sokolaj.
7. Drejtori i Drejtorisë së Administrimit të Aseteve Z. Nikolin Shtjefni.
8. Drejtori i Turizmit Z. Renaldo Xhanaj.
9. Administrator i Njësisë Administrative Shëngjin Z. Brahim Demi.

Territori që mbulon konsultimi publik: Sipërfaqja që do të ndërtohet rruga bën pjesë në ngastrat pyjore numër 33, 34a, 35c, 36a, 37a, 39a, 40, 43, 43b, 45a, 46a, 46b, 47b, 47c, 51a, 51b, 52, 60b, 61a, si dhe 62a të Ekonomisë Pyjore “Mali i Rrencit”, Shëngjin, Bashkia Lezhë.

Numri i Personave që marrin pjesë në takim: 46

Numri i femrave që marrin pjesë në takim: 16 femra



Çështja 1 për diskutim: Studimi tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që do të preken nga ndërtimi i rrugës auto By- Passi Shëngjin

Bazuar në kërkesën me numër 15924 datë 11.09.2025 të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Bashkia Lezhë, “Kërkesë për marrje në përdorim të sipërfaqes pyjore”, për ndërtimin e rrugës auto By-Passi i Shëngjinit, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, grupi i punës i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave hartoi raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore që preken nga zbatimi i këtij projekti.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një vepër që ndërtohet për nevojat e komunitetit dhe financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për llogari të Bashkisë Lezhë, sipërfaqja pyjore nuk jepet në përdorim, pasi prona është e vetë Bashkisë, por bëhet miratimi i hapjes së rrugës me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor, rezulton se sipërfaqja pyjore e kërkuar për ndërtimin e rrugës është **7.64 ha**.

Këto sipërfaqe pyjore janë në pronësi të Bashkisë Lezhë sipas VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive”.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullor publik janë të mbështetura në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

Pika 15 e VKM-së së sipërcituar; Përfshihen nga procedura e ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore, projektet e ndërtimit të infrastrukturave lineare rrugore të cilat në përputhje me projektet e miratuara kërkojnë për çdo trase të pastruar nga vegjetacioni, me gjerësi më të vogël se 10m, për efekt kadastral, bëhet vetëm zvogëlim në volum, por jo në sipërfaqe, sipas legjislacionit në fuqi.

Çështja 2 për diskutim: Rëndësia e këtij projekti dhe financimi

Drejtori i Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban Z. Flamur Kuçi tregoi rëndësinë që ky projekt do ketë sidomos në kuadrin e turizmit pasi kjo rrugë do të lidhet me aksin Milot-Balldre që do të fillojë së shpejti, duke bërë që e gjithë ngarkesa e trafikut të menjanohet plotësisht.



Ndër të tjera ai shtoi që ky projekt do të ketë një kohëzgjatje prej 18 muajsh dhe një kosto mbi 11 milion dollarë. Një nga shqetësimet që ngriti Z. Gëzim Aliaj, banor i Malit të Shëngjinit ishte, nëse do ketë prishje objektesh si dhe a do ketë nje lidhëse me zonën e banuar që mund të aksesohet nga banorët e zonës. Po ashtu anëtarja e Këshillit Bashkiak Znj. Alfrida Marku sygjeroi një trajtim më të gjerë dhe një evidence paraprake nëse Bashkia do të ketë një kompensim të familjeve ku do të kalojë gjurma e rrugës, në rastin e shpronësimeve.

Drejtori i Urbanistikës Z. Flamur Kuçi theksoi që projektuesit kanë qenë të lirë në gjetjen e gjurmës ku do të kalojë rruga por kanë pas një kujdes të veçante që mos të ketë asnjë objekt të prishur , si dhe të ketë rrugica të aksesueshme nga banorët për hyrje-dalje nga shtëpitë e tyre. Bashkia ka sjellë në kohë rekord çdo informacion për shpronësimin si dhe raportin ekonomiko-financiar që i duhet projektuesit.

Konkluzione nga takimi:

Nga ana e të pranishmëve nuk pati asnjë vëretje kundra zhvillimit të territorit dhe infrastrukturës lokale.

Struktura përgjegjëse

për mbajtjen e proces-verbalit :

ARTAN PALUSHI

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

FLORIDA ÇUNAJ





